



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the  
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



**Aspekte të zbatimit të Rregullores “Mbi krijimin e një  
procedure europiane për paditë e vogla”: Seanca,  
provat, përfaqësimi, ndihma juridike dhe shpenzimet e  
procesit, njoftimet, ankimi dhe efekti i tij në  
ekzekutimin e vendimit.”**

**TRAJNIM**

**Procedura Europiane për Paditë e Vogla**

**PËRDORIMI EFIKAS I PROCEDURAVE NDËRKUFITARE EUROPIANE**

**Tiranë, 20-21 shkurt 2021**

**Përgatiti: Dr. Silvana Çinari**

**Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë**



# Përmbajtja

- I. Roli i gjykatës në përcaktimin e procedurës
  - A. Caktimi i seancës gjyqësore
  - B. Marrja e Provave
  - C. Afatet
- II. Përfaqësimi dhe asistenca e palëve, shpenzimet e procesit
- III. Njoftimi i vendimit dhe akteve të tjera
- IV. Ankimi dhe efekti i tij në ekzekutimin e vendimit



# I. Roli i gjykatës në përcaktimin e procedurës

Qëllimi i Procedurës Europiane të Padive të Vogla (PEPV):

- Krijimi i një procedure të thjeshtuar;
- Gjykimi i shpejtë;
- Ulja e kostove;
- Rritja e aksesit në drejtësi.

Në funksion të arritjes së këtyre qëllimeve, gjykatat kanë rol kryesor në kontrollin dhe përcaktimin e procedurës, e cila udhëhiqet nga respektimi i parimit të kontradiktoritetit.

Ky rol i gjykatës është veçanërisht evident lidhur me diskrecionin e saj për:

- a. Caktimin e një seance për dëgjimin e palëve verbalisht
- b. Lejimin dhe përcaktimin e mënyrës së marrjes së provave
- c. Caktimin dhe zgjatjen e afateve.



# I. Roli i gjykatës në përcaktimin e procedurës

a. Caktimi i një seance për dëgjimin e palëve verbalisht (n. 8)

Rregulli: PEPV – procedurë e shkruar

Përjashtimi: Neni 5(1a)– zhvillimi i seancës verbale:

- vetëm nëse nuk është e mundur të jepet vendimi në bazë të provave me shkrim, ose
- nëse një palë e kërkon.

Gjykata mund të refuzojë nëse vlerëson se, një seancë verbale nuk është e nevojshme për zhvillimin e drejtë të procedurave.



# I. Roli i gjykatës në përcaktimin e procedurës

## a. Caktimi i një seance për dëgjimin e palëve verbalisht (n. 8)

Seanca verbale mbahet:

- nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë, të tilla si videokonferenca ose telekonferenca nëse janë disponueshme për gjykatën;
- Në prezencë të palëve nëse përdorimi i teknologjisë, për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes, nuk është i përshtatshëm për zhvillimin e drejtë të procedurave.



# I. Roli i gjykatës në përcaktimin e procedurës

## a. Caktimi i një seance për dëgjimin e palëve verbalisht (n. 8)

Kur personi që do të dëgjohet është me vendbanim ose vendqëndrim të zakonshëm në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga Shteti Anëtar i gjykatës së investuar, pjesëmarrja e atij personi në një seancë gjyqësore verbale me anë të videokonferencës, telekonferencës ose teknologjisë tjetër të përshtatshme të komunikimit në distancë do të rregullohet nga procedurat e parashikuara në Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 1206/2001 “Mbi bashkëpunimin midis gjykatave të Shteteve Anëtare në marrjen e provave në çështje civile ose tregtare”



# I. Roli i gjykatës në përcaktimin e procedurës

## a. Caktimi i një seance për dëgjimin e palëve verbalisht (n. 8)

### **Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1206/2001 (neni 10)**

4. Gjykata kërkuese mund t'i kërkojë gjykatës së kërkuar që të përdorë teknologjinë e komunikimit në distancë gjatë marrjes së provave, në veçanti duke përdorur videokonferencë dhe telekonferencë.

Gjykata e kërkuar do të veprojë në përputhje me një kërkesë të tillë, përveç nëse kjo është e papajtueshme me ligjin e Shtetit Anëtar të gjykatës së kërkuar ose për shkak të vështirësive të mëdha praktike.

Nëse gjykata e kërkuar nuk plotëson kërkesat për një nga këto arsye, ajo do të informojë gjykatën kërkuese, duke përdorur formularin E në Aneks.

Nëse nuk ka akses në mjetet teknike të përmendura më lart në gjykatën kërkuese ose në gjykatën e kërkuar, mjetet e tilla mund të vihen në dispozicion nga gjykatat me marrëveshje të përbashkët.



# I. Roli i gjykatës në përcaktimin e procedurës

## a. Caktimi i një seance për dëgjimin e palëve verbalisht (n. 8)

Një palë e thirrur për të qenë fizikisht e pranishme në një seancë verbale mund të kërkojë përdorimin e teknologjisë së komunikimit në distancë nëse:

- një teknologji e tillë është në dispozicion të gjykatës, dhe
- anganzhimet për të qenë fizikisht i pranishëm, veçanërisht në lidhje me kostot e mundshme të shkaktuara asaj pale, do të ishin joproporcionale me vetë padinë.

Një palë e thirrur për të marrë pjesë në një seancë gjyqësore verbale përmes teknologjisë së komunikimit në distancë mund të kërkojë të jetë fizikisht e pranishme në atë seancë.

Kërkesa parashtrohet në formularët A dhe C. Shpenzimet e pjesëmarrjes fizike në seancë mund të mos i njihen palës fituese nëse çmohen si të panevojshme nga gjykata. (n. 8(3) dhe n. 16)

Vendimmarja mbi kërkesat e mesipërme është në diskrecion të gjykatës. Ankim së bashku me vendimin përfundimtar.





# I. Roli i gjykatës në përcaktimin e procedurës

## b. Lejimi dhe përcaktimi i mënyrës së marrjes së provave (n. 9)

Gjykata përcakton mënyrat e marrjes së provave dhe provat e nevojshme për gjykimin e tyre, sipas rregullave të zbatueshme për pranueshmërinë e provave.

Ajo do të përdorë metodën më të thjeshtë për marrjen e provave.

Gjykata mund të lejojë marrjen e provave përmes deklaratave me shkrim të dëshmitarëve, ekspertëve ose palëve.

Gjykata mund të marrë prova të ekspertëve ose dëshmi verbale, vetëm nëse nuk është e mundur të jepet vendimi në bazë të provave të tjera.

Kur marrja e provave përfshin dëgjimin e një personi, seanca zhvillohet sipas kushteve për dëgjimin e palëve.



# I. Roli i gjykatës në përcaktimin e procedurës

## c. Caktimi dhe zgjatja e afateve (n. 14)

Kur gjykata cakton një afat kohor, pala e interesuar do të informohet për pasojat e mosrespektimit të tij. **P.sh.** Marrja e vendimit në rast të mos kthimit të përgjigjes nga i padituri brenda afatit 30 ditor nga njoftimi i Formularit të Padisë dhe të Përgjigjes, ose mospranimi i kërkesëpadisë në rast të mosplotësimit apo korigjimit të formularit të padisë.

Në rrethana të jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme për mbrojtjen e drejtave të palëve, gjykata mund të zgjasë:

- Afatin e caktuar prej saj për plotësimin ose korigjimin e formularit të padisë;
- Afatin 30 ditor të të paditurit për paraqitjen e përgjigjes e tij ndaj padisë;
- Afatin 14 ditor për njoftimin e kundërpadisë;
- Afatin 30 ditor për kërkimin e informacioneve shtesë për padinë, marrjen e provave dhe thirrjen e palëve në seancë verbale.

Nëse, në rrethana të jashtëzakonshme, nuk është e mundur që gjykata të respektojë afatet e për njoftimin e akteve, kryerjen e veprimeve të tilla si marrja e provave, degjimi i paleve në séance, apo marrjen e vendimit ajo do të ndër marrë hapat e kërkuar nga ato dispozita sa më shpejt që të jetë e mundur.



## II. Përfaqësimi dhe asistenca e palëve, shpenzimet e procesit

- Përfaqësimi me avokat apo me profesionist tjetër të ligjit nuk është i detyrueshëm. (Neni 10 dhe Recitali 15)
- Palët nuk janë të detyruara të bëjnë një vlerësim ligjor të padisë së tyre. (Neni 12(1))
- Qëllimi – minimizimi i shpenzimeve të procesit
- Po nëse legjislacioni i brendshëm procedural parashikon detyrimin për të qënë i përfaqësuar me avokat?
  - Neni 19: Përveç sa parashikohet në dispozitat e kësaj rregulloreje, Procedura Evropiane e Padive të Vogla rregullohet nga ligji procedural i Shtetit Anëtar në të cilin zhvillohet procedura.



## II. Përfaqësimi dhe asistenca e palëve, shpenzimet e procesit

Shtetet Anëtare kanë detyrimin të japin ndihmë praktike falas në plotësimin e formularëve dhe informacion të përgjithshëm mbi fushën e zbatimit të PEPV dhe për gjykatat kompetente për PEPV në Shtetet Anëtare. (n. 11)

Asistenca praktike përfshin informacione teknike në lidhje me vënien në dispozicion dhe plotësimin e formularëve. (Recitali 21)

Asistenca praktike mund të jepet nga personeli i gjykatës. Gjithashtu, Qendra Evropiane e Konsumatorit Evropian luan një rol në procedurën e këshillimit.

Informacioni mbi organizimin e ndihmës praktike është i disponueshëm në Portalin e-justice.

Nuk kërkohet që Shtetet Anëtare të sigurojnë ndihmë juridike në formën e një vlerësimi ligjor të një çështjeje specifike. Në Shtetet Anëtare zbatohet dispozitat e zakonshme mbi ndihmën juridike.



## II. Përfaqësimi dhe asistenca e palëve, shpenzimet e procesit

Gjykata gjithashtu ka detyrimin të informojë palët në lidhje me çështjet procedurale: (n. 12(2))

- gojarisht gjatë procedurave, ose
- me anë të komunikimeve elektronike të tilla si postë elektronike ose telekonferencë, ose
- me mjete të tjera që mund të lejohen nga ligji kombëtar.

Kur është e përshtatshme, gjykata ka detyrimin të kërkojë një zgjidhje me marrëveshje. (n. 12(3))

Mund të bëhet jo vetëm gjatë seancës verbale, por në çdo moment të gjykimit të padisë dhe kundërpadisë.



## II. Përfaqësimi dhe asistenca e palëve, shpenzimet e procesit

Shpenzimet gjyqësore konsistojnë në:

- Tarifa gjyqësore;
  - Kostot e ekspertit, dëshmitarit;
  - Përkthime
  - Shpenzime përfaqësimi.
- 
- Tarifat gjyqësore duhet të jenë proporcionale dhe të mos jenë më të larta se ato që parashikohen për procedura të ngjashme kombëtare. (N. 15)
  - Mënyra e pagesës në distancë duhet të jetë e disponueshme përmes:
    - transfertës bankare;
    - kartës së kreditit ose debitit; ose
    - pagesës direkte nga llogaria bankare e kërkuesit.



## II. Përfaqësimi dhe asistenca e palëve, shpenzimet e procesit

Shpenzimet gjyqësore përcaktohen sipas ligjit përkatës kombëtar dhe i ngarkohen palës gjyqhumbëse. Palës fituese mund të mos i njihen shpenzimet (p.sh. të përfaqësimit) nëse ato vlerësohen të panevojshme ose joproportionale me vlerën e padisë. (n. 16)

Po nëse paditësit i pranohet pjesërisht padia? Si ndahen shpenzimet?

Një ligj kombëtar, i cili parashikon ndarjen e shpenzimeve gjyqësore në rastin kur paditësit i pranohet vetëm një pjesë e padisë, nuk bie në kundërshtim me rregullin « humbësi paguan » të nenit 16 PEPV, për sa kohë që rregulli nuk është më pak i favorshëm sesa për çështjet kombëtare dhe nuk e dekurajon paditësin të përdorë PEPV.

*[Çështja C-554/17 Rebecka Jonsson v Société du Journal L'Est Républicain,  
ECLI: EU: C: 2019: 124]*



# III. Njoftimi i vendimit dhe akteve të tjera

## a. Njoftimi me postë ose elektronik (n. 13)

Formulari A i padisë dhe kundërpadisë, Formulari C i përgjigjes dhe vendimet e gjykatës njoftohen:

- a. me shërbimin postar, ose
- b. me mjete elektronike:

(i) kur mjete të tilla janë teknikisht të disponueshme dhe të pranueshme në përputhje me rregullat procedurale të Shtetit Anëtar në të cilin zhvillohet PEPV dhe, nëse pala që do të njoftohet është me vendbanim ose vendqëndrim të zakonshëm në një shtet tjetër anëtar, në përputhje me rregullat procedurale të atij Shteti Anëtar; dhe

(ii) kur pala që do të njoftohet ka pranuar paraprakisht, në mënyrë të shprehur, që dokumentet mund t'i dorëzohen atij me mjete elektronike ose ka detyrim ligjor për të pranuar këtë metodë specifike të njoftimit, sipas rregullave procedurale të Shtetit Anëtar në të cilin ajo palë është me vendbanim ose vendqëndrim të zakonshëm.

Njoftimi do të vërtetohet nga një vërtetim i marrjes duke përfshirë datën e marrjes.





## III. Njoftimi i vendimit dhe akteve të tjera

### b. Mënyra të tjera njoftimi

Të gjitha komunikimet e tjera midis gjykatave dhe palëve ose personave të tjerë nëse janë të përfshirë në procedure, do të kryhen me mjete elektronike të vërtetuara nga një vërtetim i marrjes kur:

- këto mjete janë teknikisht të disponueshme dhe të pranuar sipas rregullave procedurale të Shtetit Anëtar në cilin zhvillohet PEPV,
- me kusht që pala ose personi ka pranuar paraprakisht këtë mjet komunikimi, ose e ka detyrim ligjor për të pranuar këtë metodë specifike të njoftimit, sipas rregullave procedurale të Shtetit Anëtar në të cilin ajo palë është me vendbanim ose vendqëndrim të zakonshëm.
- Shprehja e vullnetit të pranimit paraprakisht mund të bëhet me Formularët A dhe C.



## III. Njoftimi i vendimit dhe akteve të tjera

### c. Mënyrat e njoftimit sipas Rregullores 1896/2006 (n. 13-14) në pamundësi të zbatimit të mënyrave të mësipërme

1. **Njoftimi me provë marrjeje nga i padituri/përfaqësuesi** – karakterizohen nga siguria e plotë që dokumenti i njoftuar ka arritur tek marrësi i tij:
  - a. **Personal** – i vërtetuar:
    - i. nga një vërtetim marrjeje, që përfshin datën e marrjes, i cili nënshkruhet nga i padituri, ose
    - ii. nga një dokument i nënshkruar nga personi kompetent që ka kryer njoftimin që deklaron se i padituri ka marrë dokumentin ose ka refuzuar ta marrë atë pa ndonjë shkak të ligjshëm, dhe datën e dorëzimit;
  - b. **Me postë** – i vërtetuar nga një vërtetim marrjeje, që përfshin datën e marrjes, nënshkruhet dhe kthehet nga i padituri;
  - c. **Elektronik** – p.sh. faksi ose posta elektronike (e-mail), e vërtetuar me një vërtetim marrjeje, që përfshin datën e marrjes, nënshkruhet dhe kthehet nga i padituri.



# III. Njoftimi i vendimit dhe akteve të tjera

## c. Mënyrat e njoftimit sipas Rregullores 1896/2006 (n. 13-14) në pamundësi të zbatimit të mënyrave të mësipërme

### 2. Njoftim pa provë marrjeje nga i padituri/përfaqësuesi:

- e aplikueshme vetëm nëse adresa e të paditurit dihet me siguri;
  - Në legjislacionet e brendshme të disa shteteve njihet si mënyrë njoftimi për shtetasin që ka vendqëndrimin e zakonshëm jashtë shtetit dorëzimi i akteve në zyrën e prokurorit (*remise au parquet*). Kjo mënyrë është e papajtueshme me standardet e Rregullores 1896/2006
- karakterizohet nga një mundësi shumë e lartë që i padituri të ketë marrë njoftim



# III. Njoftimi i vendimit dhe akteve të tjera

## c. Mënyrat e njoftimit sipas Rregullores 1896/2006 (n. 13-14) në pamundësi të zbatimit të mënyrave të mësipërme

### 2. Njoftim pa provë marrjeje nga i padituri/përfaqësuesi:

- a. Në adresën e banimit të të paditurit familjarëve që banojnë dhe personave që punojnë atje vetëm nëse këta persona e pranojnë/marrin urdhrin europian për pagesë, vërtetuar me vërtetim marrjeje;
  - b. Në ambjentet e biznesit të të paditurit personave të punësuar, në rastin e një të padituri të vetëpunësuar ose person juridik, vetëm nëse këta persona e pranojnë/marrin urdhrin europian për pagesë, vërtetuar me vërtetim marrjeje;
  - c. Në kutinë postare të të paditurit;
  - d. Në zyrë postare ose tek autoritetet publike kompetente **dhe** vendosja në kutinë postare të të paditurit të njoftimit me shkrim të atij depozitimi, me kusht që njoftimi me shkrim të përcaktojë qartë karakterin e dokumentit si dokument gjyqësor ose efektin ligjor të njoftimit
- Në të gjitha këto raste kryerja e njoftimit vërtetohet me një dokument të nënshkruar nga personi kompetent që ka kryer njoftimin, duke treguar mënyrën e njoftimit të përdorur, datën e njoftimit, dhe kur urdhri i është dorëzuar një personi tjetër përveç të paditurit (rastet a dhe b), emrin e personit që i është dorëzuar dokumenti dhe marrëdhëniet e tij me të paditurin.



# III. Njoftimi i vendimit dhe akteve të tjera

## c. Mënyrat e njoftimit sipas Rregullores 1896/2006 (n. 13-14) në pamundësi të zbatimit të mënyrave të mësipërme

### 2. Njoftim pa provë marrjeje nga i padituri/përfaqësuesi :

- e. Njoftim postar pa provë marrjeje kur i padituri ka adresë në Shtetin Anëtar të origjinës.
- f. Njoftim elektronik me konfirmim automatik dorëzimi, **me kusht** që i padituri ta ketë pranuar shprehimisht këtë metodë të njoftimit paraprakisht.



## IV. Ankimi dhe efekti i tij në ekzekutimin e vendimit

- Ankimi kundër një vendimi të dhënë në Procedurën Evropiane të Padive të Vogla është një mjet procedural që është rregullohet sipas legjislacionit procedural kombëtar të Shteteve Anëtare.
- Informacioni nëse ankimi është i disponueshëm dhe nëse po cila gjykatë është kompetente dhe brenda cilit afat kohor duhet të paraqitet është në dispozicion në Portalin e-Justice.
- Dispozitat e Rregullores për tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore zbatohen gjithashtu edhe në procedurat e ankimit.
- Po neni 10 i Rregullores a është i aplikueshëm? Pra a vlen përcaktimi që përfaqësimi me avokat nuk është i detyrueshëm gjatë procedurave të ankimit?



## IV. Ankimi dhe efekti i tij në ekzekutimin e vendimit

- Vendimi do të jetë i ekzekutueshëm pavarësisht ndonjë ankimi të mundshëm ndaj tij.
- Nuk do të kërkohet vendosja e ndonjë garancie.
- Megjithatë, me kërkesë të palës kundër së cilës kërkohet ekzekutimi, gjykatat mund të:
  - (a) kufizojnë procedurat e ekzekutimit tek masat e sigurimit;
  - (b) kushtëzojnë ekzekutimin me dhënien e një garancie; ose
  - (c) në rrethana të jashtëzakonshme, të pezullojë procedurat e ekzekutimit.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the  
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



# **FALEMINDERIT!**